

Në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati Qendror, ka për mision përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë. Inspektorati Qendror, është institucion publik qendror, në varësi të Kryeministrit dhe financohet nga buxheti i shtetit.

Inspektorati Qendror ka si funksion:

- të bashkërendojë dhe mbështesë veprimtarinë e inspektorateve shtetërore/vendore;
- të jap mendim këshillimor për programet e inspektimit, të hartuara nga inspektoratet shtetërore;
- të miratojë rregulla të përgjithshme, bazë, për metodologjinë e vlerësimit të riskut, programimin e inspektimeve, dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit, si dhe raportimin e veprimtarisë së inspektorateve;
- miraton rregulla të përgjithshme për treguesit e përgjithshëm të efektivitetit dhe të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, si dhe kriteret e vlerësimit të tyre;
- të japë mendime për çdo nismë ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit;
- të mbikëqyrë zbatimin e këtij ligji e të ligjit të posaçëm nga inspektorët shtetërorë, për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procedimit të inspektimit, dhe ka të drejtë të propozojë marrjen e masave disiplinore ndaj inspektorëve dhe kryeinspektorit shtetëror, në rast të konstatimit të shkeljeve prej këtyre të fundit;
- të përgatisë raportin vjetor të përgjithshëm të inspektimeve dhe ia paraqet për njohje Këshillit të Ministrave;
- të bashkërendojë veprimtarinë e trajnimit e të kualifikimit të inspektorëve;
- të miratojë kërkesat specifike për arsimimin e inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore;
- të kryejë testimin fillestar dhe periodik të inspektorëve;
- të krijojë dhe mbajë një portal unik të inspektimit *”e-Inspektimi”*, që shërben për programimin dhe bashkërendimin e inspektimeve, shkëmbimin e të dhënave ndërmjet inspektorateve të ndryshme, si dhe për informimin e publikut.